



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1147/16 prot.

Datë 15.07.2022

V E N D I M

Nr. 670/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 15.07.2022 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*” me Nr. REF-23095-03-25-2022 me objekt “*Shërbim i printimit dhe zarfimit të faturave për nevoja të UKD*” me fond limit: 7,945,020.12 (shtatë milionë e nëntëqind e dyzet e pesë mijë e njëzet presje dymbëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 17.05.2022 nga autoriteti kontraktor Sh.A Ujësjetllës Kanalizime Durrës.

“Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Albdesign PSP” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.”

Ankimues:

Operatori ekonomik “Albdesign PSP” SHPK
Rr. “Çerçiz Topulli”, Objekti Nr.17, Kashar, Tiranë

BOE “Inpress” SHPK & “Interlogistic” SHPK
Ish Blloku i Magazinave të Tregtisë, Rruga Siri Kodra, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Sh.A Ujësjetllës Kanalizime Durrës
L.17, Rr. “Dalip Peza”

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID - 19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.4. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.5. Ankimuesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 26.03.2022 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-23095-03-25-2022 me objekt

“Shërbim i printimit dhe zarfimit të faturave për nevoja të UKD” me fond limit: 7,945,020.12 (shtatë milionë e nëntëqind e dyzet e pesë mijë e njëzet presje dymbëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 17.05.2022 nga autoriteti kontraktor Sh.A Ujësjetës Kanalizime Durrës.

II.2. Në datën 17.05.2022 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.3. Në datën 23.05.2022 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave ku rezultojnë si vijon:

1. “ALBDESIGN PSP” SHPK	5,246,711.40 lekë	skualifikuar
2. BOE “Inpress” SHPK & “Interlogistic” SHPK	5,971,257.26 lekë	skualifikuar
3. “Adel CO” SHPK	7,807,606.25 lekë	kualifikuar

II.4. Në datën 30.05.2022 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës mbi njoftimin e fituesit të procedurës së prokurimit në SPE dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike të Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 72, datë 06.06.2022.

II.5. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 30.05.2022 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1147 protokollit dhe me numër ankimi elektronik A/2022/2237 e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK.

II.5.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. 1147/2 prot., datë 31.05.2022, mbi arsyen e skualifikimit të BOE “Inpress” SHPK & “Interlogistic” SHPK.

II.5.2. Me shkresën nr. 2721/3 prot, datë 06.06.2022 me objekt: “Mbi shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik Inpress”, drejtuar shoqërisë “Inpress” SHPK, për dijeni KPP-së, protokolluar me tonën me nr. 1147/3 prot., datë 09.06.2022, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Inpress” SHPK dhe **ka vendosur pranimin e pjesshëm të saj.**

II.5.3. Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin 560/2022, datë 15.06.2022 ka vendosur:

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës për procedurën e prokurimit me “Procedurë e hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-23095-03-25-2022 me objekt “Shërbim i printimit dhe zarfimit të faturave për nevoja të UKD” me fond limit: 7,945,020.12 (shtatë milionë e nëntëqind e dyzet e pesë mijë e njëzet presje dymbëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 17.05.2022 nga autoriteti kontraktor Sh.A Ujësjetës Kanalizime Durrës.
2. Të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.
3. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.5.4. Me shkresën nr. 3063 prot, datë 16.06.2022 me objekt: “Shkresë përcjellëse”, drejtuar shoqërisë “KPP-së, ka dërguar përsëri informacion mbi procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.6. Në datën 03.06.2022, operatori ekonomik ankimues “ALBDESIGN PSP” SHPK ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe në datë 02.06.2022 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar arsyet e skualifikimit të ofertës së tij ekonomike.

II.6.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. 1177/1 prot., datë 03.06.2022, lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “ALBDESIGN PSP” SHPK.

II.6.2. Me shkresën nr. 2755/3 prot., datë 07.06.2022 me objekt: “Mbi shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik ALBDESIGN PSP”, drejtuar shoqërisë “ALBDESIGN PSP” SHPK, për dijëni KPP-së, protokolluar me tonën me nr. 1177/3 prot., datë 09.06.2022, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “ALBDESIGN PSP” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “ALBDESIGN PSP” SHPK dhe **ka vendosur pranimin e pjesshëm të saj.**

II.6.3. Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin 592022, datë 15.06.2022 ka vendosur:

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës për procedurën e prokurimit me “Procedurë e hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-23095-03-25-2022 me objekt “Shërbim i printimit dhe zarfimit të faturave për nevoja të UKD” me fond limit: 7,945,020.12 (shtatë milionë e nëntëqind e dyzet e pesë mijë e njëzet presje dymbëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 17.05.2022 nga autoriteti kontraktor Sh.A Ujësjetës Kanalizime Durrës.
2. Të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.
3. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.6.4. Me shkresën nr. 1177/5 prot., datë 16.06.2022 drejtuar autoritetit kontraktor Sh.A Ujësjellës Kanalizime Durrës dhe për dijëni operatorëve ekonomikë “Inpress” SHPK dhe “ALBDESIGN PSP” SHPK, duke kërkuar të dorëzojnë pranë institucionit tonë procesverbalin e dorëzimit të mostrave nga operatori ekonomik “Albdesign PSP” SHPK dhe të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Inpress” SHPK & “Interlogistic” SHPK, si dhe mostrat e dorëzuara nga këta të fundit për artikullin (“*Letra: LaserBond 90gsm, Formati: A4*”) së bashku me dokumentacionin shoqërues të saj.

II.6.5. Me shkresën nr. 2755/6 prot., datë 20.06.2022 me objekt “*Shkresë përcjellëse*” drejtuar KPP-së, autoriteti kontraktor dorëzoi informacionin e kërkuar. Gjithashtu, bashkëlidhur shkresës së mësipërme, autoriteti kontraktor ka dorëzuar mostrat e paraqitura nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

II.7. Me shkresën 641/11prot., datë 04.05.2022 me objekt “Informacioni” Komisioni i Prokurimit Publik kërkon nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit.

“Në kuadër të shqyrtimit të ankesave të paraqitura për një procedurë prokurimi, Komisionit të Prokurimit Publik i shfaqet nevoja e kryerjes së procedurës së hetimit administrativ, lidhur me pretendimet e ngritura. Gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës konstatohen pretendime lidhur me përmbushjen e kërkesave të autoritetit kontraktor për sa i përket specifikimeve teknike të artikujve Kuti dhe Dosje për ruajtje të përhershme.

KPP ju drejtohet ju si institucion kompetent për sqarim nëse ka laboratorë privatë apo shtetërorë të akredituar dhe të certifikuar për kryerjen e testeve të letrës dhe kartonit, në Republikën e Shqipërisë.... Lutemi na informoni se cilët janë këta laboratorë.....]

II.8. Me shkresën nr. 185/1 prot., datë 09.05.2022, protokolluar me tonën me nr. 641/13, datë 10.05.2022 me objekt “Kthim-Përgjigje” nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, na informon si më poshtë vijon:

“Në lidhje me shkresën tuaj nr. 641/11, datë 04.05.2022 “Kërkesë për informacion”, Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimi ju informon se laboratorit i vetëm i kredituar prej saj për testimin e letrës dhe kartonit është EKO-STUDIO PROJEKT SHPK me adresë: Bulevardi “Gjergj Fishta” nr. 48, Tiranë.”

II.9. Me shkresën nr. 557/17 prot., datë 12.05.2022 me objekt “Kërkesë” Komisioni Prokurimit Publik kërkoj Informacion nga laboratorit testues “Eko-Studio-Projekt” SHPK si më poshtë vijon:

“Komisionit të Prokurimit Publik në kuadër të shqyrtimit të ankesës së paraqitur për një procedurë prokurimi, i shfaqet nevoja e kryerjes së procedurës së hetimit administrativ, lidhur me pretendimet e ngritura.

Gjatë shqyrtimit administrativ të një ankese konstatohen pretendime lidhur me përmbushjen e kërkesave të autoritetit kontraktor për sa i përket specifikimeve teknike për modelet “Njoftim detyrimi” me zarf, dhe kryesisht me faktin e plotësimit/mosplotësimit të specifikimeve teknike

të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoritetit kontraktor, për artikujt me treguesit si vijon:

1. Formati i njoftim detyrimeve për treguesit

Sipërfaqe e lëmuar

Pesha e një flete A4 të jetë: jo më pak se 80 gram/m²;

Përmasat e letrës të jenë: 210 x 297 mm;

2. Formati i zarfit për treguesit

Zarfi duhet të jetë DL me dritare të pozicionuar në pjesën djathtas poshtë me përmasat e dritares 10 x 4.5cm.

Përmasat e zarfit të jenë 23 x 11.5 cm.

Zarfim automatik me logo bardh e zi, për sa i përket logos së institucionit

Sqarojmë se, në përgjigje të shkresës së Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 641/11 prot., datë 04.05.2022, me objekt: “Kërkesë për informacion”, me shkresën nr. 185/1 prot., datë 09.05.2022 Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit informon se: “[...] laboratori i vetëm i akredituar prej saj për testimin e letrës dhe kartonit është Eko-Studio Projekt SHPK me adresë: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Nr.48, Tiranë”.

Sa më sipër, në zbatim të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, si edhe Vendimit Nr.867 datë 10.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore”, kërkojmë informacion nëse kompania juaj është e profilizuar ose jo për të kryer vlerësimin teknik treguesve të “Formati i njoftim detyrimeve” dhe “Formati i zarfit”, për modelet e paraqitura, objekt ankimimi, pra nëse ato janë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit. Nëse po mund të na vini në dispozicion një inxhinier/ekspert për vlerësimin e mësipërcituar. Gjithashtu, në rast të një përgjigje pozitive, kërkojmë nga ana juaj të na informoni mbi koston apo tarifat, të cilat do të mbulohen nga ankimuesi”

II.10. Me shkresën nr. 412 prot., datë 20.05.2022, protokolluar me tonën me nr. 557/18, datë 23.05.2022 me objekt “Kthim-përgjigje” nga “Eko-Studio-Projekt” SHPK, informon si më poshtë vijon:

“[...] Eko Studio Projekt SHPK ka në përbërje Laborator të Akredituar dhe të kompletuar me instrumente të standardeve bashkëkohore dhe efikase dhe kryen testim permanent dhe me kampione të komponentëve të [...] letrës dhe kartonit.”

Më pas në shkresë vijohet me tabelën me standardet e provës dhe të mostrimit dhe sqarimin se:

“Kryejmë edhe testim dhe matje të komponentëve të letrës dhe kartonit sipas standardeve të përcaktuara në vijim” [...].”

Së fundi, shoqëria “Eko-Studio Projekt” SHPK shprehet se:

“Për kryerjen e testeve dhe fiksimit e rezultateve duhet të dërgohen në ambientet e laboratorit kampione përfaqësues në mjediset e laboratorit.

Oferta ekonomike është si vijon:

Nr.	Shërbim	Njësia	Sasia	Çmimi në lek pa TVSH
-----	---------	--------	-------	----------------------

1.	Analiza gramaturës	Copë/një testim	1	5700
----	--------------------	-----------------	---	------

v.o Në cmimet e mësipërme është përfshirë përgatitja e kampionit sipas standardeve të mostrimit si dhe kryerja e testimit dhe nxjerrja e rezultatit.”

II.11. Për testimin e mostrave të dorëzuara nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK, dhe të operatorit ekonomi “Albdesign PSP” SHPK, me Vendimin nr. 604/2022, datë 27.06.2022 Komisioni i Prokurimit Publik vendosi si më poshtë vijon:

1. Të urdhërojë kryerjen e ekspertizës për ekzaminimin e faturave të paraqitura nga operatorët ekonomikë, konkretisht nga BOE “Inpress” SHPK & “Interlogistic” SHPK dhe “Albdesign PSP” SHPK nga laboratorit i akredituar i shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-23095-03-25-2022 me objekt “Shërbim i printimit dhe zarfimit të faturave për nevoja të UKD” me fond limit: 7,945,020.12 (shtatë milionë e nëntëqind e dyzet e pesë mijë e njëzet presje dymbëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 17.05.2022 nga autoriteti kontraktor Sh.A Ujësjetllës Kanalizime Durrës.
2. Të testohen mostrat e BOE “Inpress” SHPK & “Interlogistic” SHPK:
Kriteri në DST: Operatori ekonomik duhet të paraqesë 10 (copë) fatura sipas të gjitha specifikimeve teknike të kërkuara në DST.
Specifikimi teknik (shtojca 5 në DST) Laser Bond 90 gsm.
3. Të testohen mostrat e operatori ekonomik “Albdesign PSP” SHPK:
Kriteri në DST: Operatori ekonomik duhet të paraqesë 10 (copë) fatura sipas të gjitha specifikimeve teknike të kërkuara në DST.
Specifikimi teknik (shtojca 5 në DST) Laser Bond 90 gsm.
1. BOE “Inpress” SHPK & “Interlogistic” SHPK, të parapaguajë për llogari të shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK, shumën prej 5,700 L pa TVSh sipas tarifës së përcaktuar me nr. 412 prot., datë 20.05.2022, protokolluar me tonën me nr. 557/18, datë 23.05.2022, për testimin e mostrave dhe të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, së bashku me kopje të faturës financiare të parapagimit, brenda datës 29.06.2022 ora 10:00.
2. Operatori ekonomik “Albdesign PSP” SHPK, të parapaguajë për llogari të shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK, shumën prej 5,700 L pa TVSh sipas tarifës së përcaktuar me nr. 412 prot., datë 20.05.2022, protokolluar me tonën me nr. 557/18, datë 23.05.2022, për testimin e mostrave dhe të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, së bashku me kopje të faturës financiare të parapagimit, brenda datës 29.06.2022 ora 10:00.
3. Në orën 10.10 të paraqiten pranë Komisionit të Prokurimit Publik përfaqësues të BOE “Inpress” SHPK & “Interlogistic” SHPK dhe përfaqësues të autoritetit kontraktor Sh.A Ujësjetllës Kanalizime Durrës, për verifikimin e mostrave për të cilët ngrihen pretendimet.
4. Në orën 10.30 të paraqiten pranë Komisionit të Prokurimit Publik përfaqësues të operatorit ekonomik “Albdesign PSP” SHPK dhe përfaqësues të autoritetit

kontraktor Sh.A Ujësjetllës Kanalizime Durrës, për verifikimin e mostrave për të cilët ngrihen pretendimet.

5. *Më datë 29.06.2022 ora 12.00 përfaqësuesit e pranishëm në këtë seancë do të dorëzojnë mostrat për testim pranë laboratorit të shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK*
6. *Të njoftojë laboratorin e shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK për kryerjen e testimit të mostrave në datën 29.06.2022.*
7. *Afati për kthimin e përgjigjes së testimit brenda 10 (dhjetë) ditëve punë, nga dita e nesërme e marrjes në dorëzim të mostrave.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.12. Në datën 29.06.2022 është protokolluar me nr. 1147/5 prot., dhe nr. 1147/9 prot., shkresat e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK me objekt “Kërkohet rishikimi i vendimit të ndërmjetëm të KPP nr. 604/2022”.

II.13. Në datën 29.06.2022 dhe 01.07.2022, në ambientet e Komisionit të Prokurimit Publik u mbajt seancë dëgjimore me përfaqësues të shoqërisë “Albdesign PSP” SHPK, të shoqërisë “Inpress” SHPK dhe KPP-së. Në prani të tre palëve të sipërcituara, në përgjigje të kërkesës së Komisionit të Prokurimit Publik për përzgjedhjen e mostrës që do t’i nënshtrohet testimit, nga ana e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK u deklarua mostra me nr.13 për t’u testuar në Laboratorin e shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK dhe nga ana e operatorit ekonomik “Albdesign PSP” SHPK u deklarua mostra me nr.01. Gjatë kësaj seance, përfaqësuesi nga autoriteti kontraktor Sh.A Ujësjetllës Kanalizime Durrës ka depozituar të gjitha mostrat e dorëzuara nga bashkimit të “Inpress” SHPK & “Interlogistic” SHPK dhe mostrat e dorëzuara operatori ekonomik “Albdesign PSP” SHPK. Këto mostra u protokolluan pranë zyrës së prorokollit të KPP-së me nr. 1147/10 prot., dhe nr. 1147/11 prot.,.

II.14. Në përgjigje të shkresave të mësipërme për rishikim vendimi nga ana e operatorit ekonomik ankimues “Inpress” SHPK, KPP mori vendimin Nr. 666/2022, datë 13.07.2022, ku vendosi:

1. *Të mos pranojë kërkesën e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK për rishikim vendimi 604/2022, datë 27.06.2022 për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-23095-03-25-2022 me objekt “Shërbim i printimit dhe zarfimit të faturave për nevoja të UKD” me fond limit: 7,945,020.12 (shtatë milionë e nëntëqind e dyzet e pesë mijë e njëzet presje dymbëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 17.05.2022 nga autoriteti kontraktor Sh.A Ujësjetllës Kanalizime Durrës.*

II.15. Me anë të shkresës nr.510/1 prot., datë 11.07.2022, protokolluar me tonën me nr.1147/14 prot., datë 13.07.2022, Laboratori “Eko – Studio – Projekt” SHPK ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik “Raport Testimi” të mostrave, nr. 810 Prot. datë 11.07.2022. Konkretisht, ndër të tjera në raportin e mësipërm theksohet:

[...] *Mostra e parë e peshuar: Analiza e letrës me kod SPS-PS-510-I-Matja u realizua për kampionin e tipit zarf letre bardh e zi e vulosur nga kompania Inpress. Bazuar në formulën e sipër përmendur masa e zarfit është 88.43 g/m².*

Mostra e dytë e peshuar: Analiza e letrës me kod SPS-PS-510-II-Matja u realizua për kampionin e tipit zarf letre bardh e zi e vulosur nga kompania Albdesign PSP. Bazuar në formulën e sipër përmendur masa e zarfit është 88.29 g/m².

II.16. Nga verifikimet e kryera, rezulton se nuk janë paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik argumente nga subjekte të interesuara lidhur me ankesat e paraqitura nga operatorët ekonomikë ankimues, sipas parashikimeve të nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e secilit operatori ekonomik ankimues, konkretisht BOE “Inpress” SHPK & “Interlogistic” SHPK dhe operatori ekonomik “Albdesign PSP” SHPK për skualifikimin e BOE “Inpress” SHPK & “Interlogistic” SHPK si dhe të Albdesign PSP” SHPK, me arsyetimin se: *“pesha e mostrës së letrës nuk është sipas specifikimeve të kërkuara, kjo referuar analizës së kryer në një Laborator Testimi të njërës prej mostrave, ku konstatohet se pesha e letrës është më e vogël se prej 90 g/m²”,* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8 “*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*”, pika 2.3. të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

2.3 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.3.3 *Operatori ekonomik duhet të paraqesë 10 (copë) fatura sipas të gjitha specifikimeve teknike të kërkuara në dst, në datën dhe orën e caktuar si afat i fundit për dorëzimin dhe hapjen e ofertave.*

III.1.2. Në shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet si më poshtë:

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Printimi i faturës dhe palosje në versionin “Selfmailer”

Formati: A4

Letra: LaserBond 90gsm

Fatura duhet të zarfohet në formën “selfmailer” me perforim dhe të paloset në formën “C”

Ngjyra:

Letra e paraprintuar (Logo kryesore në të dyja krahët e faturës si dhe reklama në pjesën e mbrapme) të jetë me ngjyra dhe të dhënat e tjera. Imazhi i letrës mund të ndryshojë çdo tre (3) muaj.

Gjithashtu shuma debitore dhe teksti që e shoqeron si dhe fjala “Debitor” duhet të jetë me ngjyrë të kuqe (për klientët debitorë).

Të dhënat e tjera të faturës me ngjyrë të zezë.

Fatura duhet të ketë dy linja perforimi përgjatë gjatësisë së faturës për hapjen e zarfit si edhe instruksionet përkatëse për hapjen e zarfit. Ngjijtje nga krahët anësore. Perforim horizontal tek linja e treguar. Cdo faturë, në pjesën anësore mbrapa duhet të ketë numrin serial të lotit të fileve, zonën dhe numeratorin për zonë.

Bashkëngjitur edhe një simulim se si duhet fatura (debitore).

EMERA MEMBER
Nr. kontrole: xxxxxxxx
Oarku Dures
Matesa, adresa adresa
ZONA 1 / 101 / 0

Ujeshelles Kanalizime Dures shtu (UKD) njehon klientit e saj se peridha e faturnit per zontin e qytetit do te jeti nga data 1 deri ne 31. Eshite vendosur keto zontin e Plazhit faturnit do te kryhet nga data 1 deri ne 31. Eshite vendosur keto faturni per zontin e Ujeshelles, agjencie e Postes Shqiptare, dogjet e bankave te nivellit gjithe orke e Ujeshelles, agjencie e Postes Shqiptare, dogjet e bankave te nivellit te dyte si dhe ne plakt e Unionsit Financuar (Union Bank dhe Western Union).



Ujeshelles Kanalizime Dures Sh.A | Rruga "Dajp Peza" L. 17 | Tel/Fax: 052 238 328 | AL 2001 Dures

KONSUMATORE FAMILJARE: Bashkimi ne marveshten midis UKD shtu dhe Bashkise Dures per Vjehen e Taksave dhe Tarifave kundrejt per iden 2014, me qelimin bashkimit e te dhemave te tyre. Ju lutemi parashihni pranë Zyrtare te shqiptimit te UKD shtu dhe Karta kontrole. Lejshite e regjistrimit te Taksave vendike dhe kodin i uej te litem taksave vendike Kopje te Dokumentit te Projesit se mbeshtetje (koncepti shtu).

KONSUMATORE: Ne rast mospagimit te Dures vendike detyto te muajit pasardhës, qe ju ndehprit shqiptimit i famzimit me uej dhe kanalizime nga UKD shtu. Ne rast rasteje ne menyre bashkive do te ndiqen procedurat ligjore, ne bashkëpunim me organet bashkive. Ju faleminderim per bashkëpunimin.

Indetuar klienti! Ju njoftojmë se ju jeni detyhor ne vlerën **1.030.36 Leka**. Ju lutemi parqyrtuni pranë orkeve te Ujeshelles Kanalizime Dures (UKD) per te shijer dotyrimin uej. **pasti ne te kundert do ju ndehprit qdo sherbim qe ofron UKD.**

Prashitet Dures	020000025
Prashitet	250402474-011
B.I.K.T	40400042
INDS	1190771000012
Banka Dures	600000711
Udhjet	1201616830011
Tikava Bank	0200-400038-100
Adresa	AL05010210115200014
Chifra Agjente	AL1501020000000001
Banka	0800030047



Ujesjelles Kanalizime Durres Sh.A
Lagjia 17 Rruga Dalip Peza
NIPT J61819502V
tel: 052 238 329
web: www.ukdurrres.al
email: info@ukdurrres.al

Faturat mund te paguhen prane
arkave dhe sportevele te UKD
si dhe ne te gjitha bankat ne Durres.

FATURË TATIMORE Shkurt 2016

EMER MBIEMER		Nr. i faturës:	0000000000000000
Qarku: Durres		Data e faturës:	Shkurt 2016
Ndertesa: adresa adresa adresa		Nr. i kontratës:	xxxxxxx
ZONA 1 / 101 / 0		Plani Tarifor:	Sipas matësit Familje me Kanalizime

KUJTESE!

PAGESA: - Fatura e konsumit te ujit te pijshem eshte Titull Ekzekutiv ne baze te Ligjit Nr.8975, date 21.11.2002

ANKIMIMI: - Ne rast se konsumatori nuk eshte dakort me sasinë e ujit qe i eshte faturuar duhet te paraqese ankese me shkrim prane zyrate te UKD-se ose ne faqen e internetit selfcare.ukdurrres.al bazuar ne kartën e tij te identitetit.

Nr. MATESIT	Nr. VULES	LEXIMI I MUAJIT	LEXIMI I MËPARSHËM	KONSUMI I MUAJIT
XXXXXXXXXX	XXXXXX	23.00		23.00
Aforfe:		0.00	Total me Mates:	0.00
Total:				0.00

PËRSHKRIMI	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI	VLERA
Ujë i pijshëm	m3	0.00	58.00	0.00
Largimi e perpunimi i ujrave te ndotura	m3	0.00	35.00	0.00
Tarifë shërbimi				100.00

Vlera	100.00			
TVSH (20%)	20.00			
TARIFAT DHE TAKSAT BASHKIAKE				
TARIFAT & TAKSAT	NJËSIA	SASIA	TAKSA	VLERA
Tarifa Ndricimit	Njesi	0.00	0.00	0.00
Tarifa e Gjelberimit	Njesi	0.00	0.00	0.00
Tarifa e Pastrimit	Njesi	0.00	0.00	0.00
Taksa Ndertese	m2	0.00	0.00	0.00

Detyrimi juaj i prapambetur eshte 1,830.36 Loke

Vlera	0.00
VLERA TOTALE PER TU PAGUAR	120.00

Pagesa duhet kryer brenda 30-03-2016



Kujdes: Për të bërë pagesën duhet të paraqiteni me këtë



KONTRAKTUESI	
EMER MBIEMER	
Qarku: Durres	
Ndertesa: adresa adresa adresa	
Hyrja: Apartamenti: Radha: 0	
Nr. i fatures:	0000000000000000
Vlera perfshire TVSH:	120.00
Taksa dhe tarifa vendore	0.00
SHUMA PER T'U PAGUAR	120.00
Nr. i kontratës:	xxxxxxx
Shkurt	
Data dhe firma	

Faturen tuaj mund ta printoni ne faqen e internetit selfcare.ukdurrres.al

PJESA MBRAPA

III.1.4. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatorët ekonomikë ankimes BOE “Inpress” SHPK & “Interlogistic” SHPK dhe operatori ekonomik “Albdesign PSP” SHPK kanë dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- *Mostrat e dorëzuara*

III.1.5. Në nenin 77 pika 1 dhe pika 4 “Kërkesat për kualifikim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) *përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) *gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) *afësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

[...]

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.1.6. Në nenin 41, pika 2 dhe 6 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

2.Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

6. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës

III.1.7. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

III.1.8. Referuar kritereve të veçanta të kualifikimit rezulton, se është kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, në datën dhe orën e hapjes së ofertave, duhet të paraqesin 10 (copë) fatura sipas të gjitha specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit, në datën dhe orën e caktuar si afat i fundit për dorëzimin dhe hapjen e ofertave.

III.1.9. Nisur nga pretendimet e operatorëve ekonomikë ankimues, dokumentacionit të autoritetit kontraktor, me qëllim shqyrtimin e drejtë të pretendimeve të ankimuesëve, në mbështetje të pikës 5, të nenit 115 të LPP, KPP, gjykoi të domosdoshme kryerjen e testimit të mostrës së paraqitur nga BOE “Inpress” SHPK & “Interlogistic” SHPK dhe operatori ekonomik “Albdesign PSP” SHPK, me qëllim verifikimin e përmbushjes së specifikimeve teknike të këtyre mostrave. Në përgjigje të shkresës së Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 641/11 prot., datë 04.05.2022, me objekt: “Kërkesë për informacion”, me shkresën nr. 185/1 prot., datë 09.05.2022 Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit informon KPP-në se: “[...] laboratorit i vetëm i akredituar prej saj për testimin e letrës dhe kartonit është Eko-Studio Projekt SHPK me adresë: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Nr.48, Tiranë”.

Në mbështetje të shkresës së mësipërme, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi informacion shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK, nëse kjo e fundit ishte e profilizuar ose jo për të kryer vlerësimin teknik të treguesve të “Analiza e gramaturës”, për modelet e paraqitura, objekt-ankimimi, pra nëse ato janë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit.

Në datën 23.05.2022 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 557/18 prot., shkresa e shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK me nr. 412 prot., datë 20.05.2022 me e cila deklaroi se *ka në përbërje Laborator të Akredituar dhe të kompletuar me instrumente të standardeve bashkëkohore dhe efikase dhe kryen testim permanent dhe me kampione të komponentëve të [...] letrës dhe kartonit, si dhe bën me dije se për kryerjen e testeve dhe fiksimit e rezultateve duhet të dërgohen në ambientet e laboratorit kampione përfaqësues në mjediset e laboratorit.*

Në datën 24.5.2022, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin nr. 604/2022, për testimin e mostrave sipas: *Kriteri në DST: Operatori ekonomik duhet të paraqesë 10 (copë) fatura sipas të gjitha specifikimeve teknike të kërkuara në DST. Specifikimi teknik (shtojca 5 në DST) Laser Bond 90 gsm.*

Në datën 29.06.2022, në ambientet e Komisionit të Prokurimit Publik u mbajt një seancë dëgjimore me përfaqësues të shoqërisë “Albdesign PSP” SHPK, të shoqërisë “Inpress” SHPK dhe KPP-së. Në prani të tre palëve të sipërcituara, në përgjigje të kërkesës së Komisionit të Prokurimit Publik për përzgjedhjen e mostrës që do t’i nënshtrohet testimit, nga ana e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK u deklarua mostra me nr.13 për t’u testuar në Laboratorin e shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK dhe nga ana e operatorit ekonomik “Albdesign PSP” SHPK u deklarua mostra me nr.01.

Me anë të shkresës nr.510/1 prot., datë 11.07.2022, protokolluar me tonën me nr.1147/14 prot., datë 13.07.2022, Laboratori “Eko – Studio – Projekt” SHPK ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik “Raport Testimi” të mostrave, nr. 810 Prot. datë 11.07.2022. Konkretisht, ndër të tjera në raportin e mësipërm theksohet:

[...] *Mostra e parë e peshuar: Analiza e letrës me kod SPS-PS-510-I-Matja u realizua për kampionin e tipit zarf letre bardh e zi e vulosur nga kompania Inpress. Bazuar në formulën e sipër përmendur masa e zarfit është 88.43 g/m².*

Mostra e dytë e peshuar: Analiza e letrës me kod SPS-PS-510-II-Matja u realizua për kampionin e tipit zarf letre bardh e zi e vulosur nga kompania Albdesign PSP. Bazuar në formulën e sipër përmendur masa e zarfit është 88.29 g/m².

III.1.11. KPP referuar Raportit të Testimit të mostrave, të dorëzuar në datë 07.06.2022 nga Laboratori “Eko – Studio – Projekt” SHPK, si një laborator i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit për testimin e mostrave të sipërpërmendura, konstatohet, se mostra e paraqitur për testim nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK si dhe nga ana e operatorit ekonomik “Albdesign PSP” SHPK, nuk janë në përputhje me specifikimet teknike, pasi referuar fletave të analizave respektive për secilën mostër të dorëzuar, *Mostra e parë e peshuar: Analiza e letrës me kod SPS-PS-510-I-Matja u realizua për kampionin e tipit zarf letre bardh e zi e vulosur nga kompania Inpress. Bazuar në formulën e sipërpërmendur masa e zarfit është 88.43 g/m², ndërsa “Mostra e dytë e peshuar: Analiza e letrës me kod SPS-PS-510-II-Matja u realizua për kampionin e tipit zarf letre bardh e zi e vulosur nga kompania Albdesign PSP. Bazuar në formulën e sipërpërmendur masa e zarfit është 88.29 g/m², ndërkohë në specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor **Letra: LaserBond 90gsm**”.*

Në përfundim, sa më sipër analizuar, nga verifikimi i dokumentacionit dhe Raportit të Testimit të mostrës nga Laboratori i akredituar “Eko – Studio – Projekt” SHPK, konstatohet se mostra për “Letra A4”, nuk është në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Në këto kushte KPP gjykon, se mostra, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të siguruar shërbimin apo mallin e kërkuar nga autoriteti kontraktor në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të përcaktuar në dokumentet e tenderit përbën shkak për skualifikim.

Sa më sipër, pretendimi i BOE ankimues “Inpress” SHPK & “Interlogistic” SHPK dhe operatorit ekonomik ankimues “Albdesign PSP” SHPK, nuk qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2018, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e BOE “Inpress” SHPK & “Interlogistic” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-23095-03-25-2022 me objekt “Shërbim i printimit dhe zarfimit të faturave për nevoja të UKD” me fond limit: 7,945,020.12 (shtatë milionë e nëntëqind e dyzet e pesë mijë e njëzet presje dymbëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 17.05.2022 nga autoriteti kontraktor Sh.A Ujësjellës Kanalizime Durrës.
 2. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Albdesign PSP” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.
 3. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifave financiare të paguara nga BOE “Inpress” SHPK & “Interlogistic” SHPK.
 5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifave financiare të paguara nga operatori ekonomik “Albdesign PSP” SHPK.
 6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

